EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT JETË DHE SHËNDET I SPORTISTIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jetë dhe Shëndet i Sportistit është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në mënyrën dhe masën e parashikuar në këtë kontratë, nëse ndodh të vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1. Përcaktime

a) Kushtet e përgjithshme të kontratës së Sigurimit të Jetës dhe Shëndetit të Sportistëve, polica e sigurimit dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet atyre, do të quhet "**Kontrata e Sigurimit**".
b) Kushtet e përgjithshme (dhe të veçanta, nëse ka) të kontratës së sigurimit të Jetës dhe Shëndetit të Sportistëve, do të quhen "**Kushtet e Sigurimit**".
c) Kompania e sigurimit "SiCRED" do të quhet "**Siguruesi**".
d) Grupi i përbërë prej më shumë se 5 Sportistësh dhe që kanë të drejtë të sigurohen me anë të kësaj kontrate, do të quhet "**Grup i Siguruar**".
e) Personi fizik, pjesëmarrës në Grupin e Siguruar, jeta e të cilit do të sigurohet sipas kontratës së sigurimit të Jetës dhe Shëndetit të Sportistëve, do të quhet "**I Siguruari**".
f) Personi fizik apo juridik që nënshkruan kontratën e sigurimit, do të quhet "**Kontraktuesi**".
g) Dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë do të quhet "**Çertifikata e Sigurimit**".
h) Personi fizik apo juridik që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur nga i Siguruari në Çertifikatën e Sigurimit, do të quhet "**Përfituesi**".
i) Shuma e mjeteve monetare që i Siguruari dhe/ose Kontraktuesi i paguajnë Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate, këtu e më poshtë, do të quhet "**Prim i Sigurimit**".
j) Shuma maksimale e mjeteve monetare që Siguruesi merr përsipër të paguajë me vërtetimin e rastit të sigurimit, në favor të të Siguruarit apo Përfituesit, do të quhet "**Shuma e Sigurimit**".
k) Shuma e mjeteve monetare që Siguruesi i paguan të Siguruarit apo Përfituesit, me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit, do të quhet "**Përfitim**".
l) Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit, sipas kushtet e kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga i Siguruari, tërësisht ose pjesërisht, kjo kontratë do të quhet "**Kontratë Sigurimi Kontributor në Grup**".
m) Punëdhënësi (Presidenti dhe/ose Drejtuesi i Klubit) i cili paguan plotësisht apo pjesërisht primin në favor të të Siguruarit, do të quhet "**Policëmbajtësi**".
n) Humbja e jetës së të Siguruarit, pavarësisht nga shkaku, gjatë një aktiviteti të mbuluar, paaftësia e përkohshme apo e përhershme e të Siguruarit të shkaktuara nga aksidenti (trauma sportive), do të quhet "**Rast Sigurimi**".
o) Aktivitetet sportive zyrtare të organizuara nga federata përkatëse sipas kalendarit sportiv përkatës, me shtrirje mbulimi: a) brenda ambienteve sportive (stadiume apo salla sportive); b) gjatë kohës së përcaktuar të garës, do të quhet "**Aktivitet i Mbuluar**".
p) Vdekja ose paaftësia e të Siguruarit që shkaktohet nga një veprim i rastit, i dhunshëm, i dukshëm i jashtëm, mbi të Siguruarin, gjatë një aktiviteti të mbuluar, do të quhet "**Aksident**".

q) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit për të ushtruar profesionin e tij (sportin përkatës), të shkaktuar nga aksidenti dhe e vërtetuar nga organi mjekësor kompetent pas mbarimit të periudhës prej një viti nga fillimi i paaftësisë, do të quhet "**Paaftësi e Përhershme**".

r) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit për të ushtruar përkohësisht profesionin e tij (sportin përkatës) dhe kur kjo periudhë e vlerësuar nga mjeku është mbi një muaj, do të quhet "**Paaftësi e Përkohshme**".

s) Shpenzimet për trajtimin spitalor dhe ndërhyrje kirurgjikale të kryera në një klinikë brenda ose jashtë vendit, të cilat lindin si pasojë e aksidentit (traumës sportive), do të quhen "**Shpenzime Mjekësore**".

1.2 E drejta për t'u siguruar

a) Kanë të drejtë të sigurohen me këtë kontratë të gjithë sportistët profesionistë të klubeve dhe ekipeve shqiptare, që janë të federuar pranë Federatave përkatëse dhe që aktivitetin e tyre sportiv e ushtrojnë ne kategoritë e para.

b) Kanë të drejtë të sigurohen me këtë kontratë sigurimi të gjithë sportistët anëtarë të ekipeve përfaqësuese (kombëtare) pavarësisht nëse aktivitetin e tyre sportiv e ushtrojnë ose jo me një nga ekipet shqiptare.

c) Kanë të drejtë të sigurohen me anë të kësaj kontrate të gjithë anëtarët e stafit drejtues të ekipit (si trajnerët, masazhatorët etj.)

d) Nuk kanë të drejtë të sigurohen me këtë kontratë sigurimi, sportistët e ekipeve amatore apo të kategorive të dyta sipas klasifikimit specifik të federatave përkatëse.

e) Nuk kanë të drejtë të sigurohen dhe nuk do të sigurohen sportistët që vuajnë nga dëmtime të mëparshme aksidentale (trauma sportive).

1.3 Përfitimet e Pagueshme

a) Rreziku i vdekjes i të Siguruarit (sportistit), për shkaqe natyrore apo aksidentale;

b) Rreziku i mbetjes i paaftë i përhershëm i plotë për shkaqe dhe dëmtime të lidhura me aksidentin;

c) Shpenzimet për trajtim mjekësor të specializuar në rast dëmtimi aksidental (traumë sportive).

1.4 Përjashtime të Zbatueshme

Nuk mbulohen nga kjo kontratë sigurimi dhe nuk do të paguhet për:

1. Koston e shpenzimeve për trajtim mjekësor të paguar nga ndonjë institucion tjetër, apo e mbuluar nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.
2. Përfitimet për shkak të dëmtimeve të pësuara jashtë "aktivitetit të mbuluar" e përcaktuar më parë.
3. Paaftësinë e përhershme apo shpenzimet mjekësore për shkak të një dëmtimi aksidental (traumës sportive) që ka ekzistuar më parë se kontrata të hyjë në fuqi.
4. Ndërhyrjet kirurgjikale, kontrollet apo kurimet për pasoja që nuk lidhen me kushtet e mbulimit në sigurim sipas kësaj kontrate.
5. Vdekje natyrore të shkaktuar nga sëmundje, gjendje psikologjike, të njohura apo të diagnostikuara më parë.
6. Veprime të qëllimshme të kryera me dashje nga i siguruari në dëm të tij për efekt përfitimi.
7. Akte të kryera me dashje apo të tentuara nga Policëmbajtësi, kontraktuesi apo përfituesi në dëm të të Siguruarit.
8. Dëmtimet e pësuara nga i Siguruari si rezultat i veprimeve apo kundërveprimeve të tij në kundërshtim me etikën sportive dhe rregullat "fair play".
9. Çdo lloj defekti fizik përveçse kur është deklaruar nga i Siguruari edhe është pranuar nga Siguruesi.
10. Dëmtimie apo sëmundjet e pësuara për shkak të infektimit masiv pandemik dhe bioterrorizmit.

1.5 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

1. Me ndodhjen e rastit të sigurimit, i Siguruari apo Përfituesi detyrohen të njoftojnë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e saj, si dhe të zbatojnë porositë e dhëna nga Siguruesi.
2. Në rast të ndodhjes së rastit të sigurimit, Kontraktuesi është i detyruar t'i paraqesë Siguruesit:
   a) Kërkesën për dëmshpërblim;
   b) Raportin mjekësor të përpiluar nga mjeku i ekipit si dhe mjeku i Federatës përkatëse, ku të vërtetojnë dëmtimin e pësuar, shkallën e dëmtimit dhe domosdoshmërinë për t'u trajtuar;
   c) Procesverbalin (protokollin) e ndeshjes;
   d) Çdo dokumentacion të kërkuar nga Siguruesi;
3. Dokumentacioni i plotë i dorëzohet Siguruesit. Shpenzimet për grumbullimin dhe dërgimin e dokumentacionit janë në ngarkim të të Siguruarit a Përfituesit.
4. Siguruesi duhet të paguajë dëmshpërblimin që rrjedh nga kjo kontratë sigurimi brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së dokumenteve të nevojshme dhe që konsiderohen të plota. Çdo pagesë bëhet në monedhën e treguar në kontratën e Sigurimit.

1.6. Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit, janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.